



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 234 Prot.

Tiranë, më 16.02 2018

VENDIM Nr. 18, datë 18.01.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, datë 18.01.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, për *Tokat Shtesë (Extra Lands Batch 8), Skrapar, në kuadër të projektit "TAP"*- subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, për *Tokat Shtesë (Extra Lands Batch 8), Skrapar, në kuadër të projektit "TAP"*- subjekti "Spiecapag Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të vijojnë punimet e zbatimit për Tokat Shtesë ((Extra Lands Batch 8), Skrapar, në kuadër të projektit "TAP" duke kryer ndjekjen në mënyrë periodike ditore të punimeve të gërmimit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur më parë ndërmjet Subjektit "SPIECAPAG Shqipëria", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, për këtë zonë.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTER



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO